



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT**  
**AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE**  
**KUALIFIKIMEVE**

**PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMIN E**  
**MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE**

**TEORIA PROFESIONALE E INTEGRUAR:**  
**KUALIFIKIMI PROFESIONAL “GJEODEZI”**

**(Niveli IV në KSHK, referuar Niveli IV në KEK)**

**Tiranë 2024**

## 1. Udhëzime të përgjithshme

Ky program orientues ndihmon në përgatitjen e nxënësve për Kualifikimin Profesional “**Gjeodezi**” me strukturë 4 vite mësimore, për provimin e detyruar “**Teori profesionale e integruar**” të Maturës Shtetërore Profesionale. Ai synon orientimin e përgatitjes së nxënësve nëpërmjet përqendrimit në njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të lëndëve teorike profesionale. Njëherazi, ndihmon edhe në verifikimin paraprak të përgatitjes përfundimtare të nxënësve sepse mundëson zhvillimin e testeve përmbljedhëse. Programi orientues për provimin e “**Teorisë profesionale të integruar**” bazohet në:

- Programet e lëndëve teorike profesionale të Kualifikimit Profesional “**Gjeodezi**”, Niveli IV i KSHK-së (klasa e 10-të, 11-të, 12-të dhe 13-të).
- Udhëzimin e përbashkët të MAS dhe MFE nr. 27, datë 12.12.2023 “Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore dhe Maturës Shtetërore Profesionale 2024”.

Në të përfshihen njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të këtyre programeve dhe që janë në themel të formimit teorik profesional të nxënësit.

## 2. Udhëzime për zbatimin e programit

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes sepse evidenton dhe përforcon njohuritë teorike, por dhe aftësitë e nxënësve për aplikimin e njohurive në situata të njohura e të reja si dhe analizën dhe vlerësimin e këtyre situatave. Specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës provimit të “**Teorisë profesionale të integruar**”, nuk duhet të përfshijnë për vlerësim tema mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program. Përgatitja e nxënësve për provim të bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe duke përdorur një larmi metodash dhe mjetesh.

Qëllimi i provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale është vlerësimi i të nxënësit dhe arritjeve si dhe përzgjedhjen e nxënësve për arsimim të mëtejshëm.

Gjatë punës për përgatitjen e nxënësve për provimin e detyruar “**Teori profesionale të integruar**” të Maturës Shtetërore Profesionale, është e rëndësishme që herë pas here mësuesi të zhvillojë teste të nxënësve të tij, me teste që mund t’i hartojë vetë duke u bazuar në modelet e mëparshme të testeve të Maturës Shtetërore për teorinë profesionale.

Testi për Kualifikimin Profesional “**Gjeodezi**” do të ndërtohet në mënyrë të tillë ku të jenë të përfshira të tri nivelet e vështirësisë: niveli bazë, niveli mesatar dhe niveli i lartë. Njëkohësisht, edhe shpërndarja e pikëve në test do të jetë në varësi të përqindjeve që zë çdo nivel. Gjatë hartimit të njësive të testit duhet të mbahen parasysh synimet e përgjithshme, në skeletkurrikulat përkatëse, të temave të përzgjedhura në këtë program.

Ky program përmban rreth 30% të vëllimit të përgjithshëm të lëndëve të kulturës profesionale. Në këtë program janë përfshirë ato lëndë, të cilat përbëjnë bazën kryesore dhe thelbësore për formimin profesional të nxënësve.

Nxënësit duhet të kenë parasysh se lënda, e cila ka peshën më të madhe në këtë program orientues të Maturës Shtetërore Profesionale, në test do të përfaqësohet nga një numër më i madh pyetjesh.

### 3. Lëndët dhe temat përkatëse

Në programin orientues të provimit të “**Teorisë profesionale të integruar**” në kuadrin e provimit të detyruar “**Teori profesionale e integruar**”, të Maturës Shtetërore Profesionale, për Kualifikimin Profesional “ **Gjeodezi**“, do të përfshihen programet e lëndëve profesionale të mëposhtme:

1. Gjeodezi, kl. 10, 11, 12 dhe kl. 13-të.
2. Llogaritje gjeodezike, kl. 11-të.
3. Gjeodezi e zbatuar, kl. 12, 13-të
4. Gjeoinformatikë, kl.12-të

**Tabela 1: Lëndët dhe peshat përkatëse në programin orientues**

<b>Nr</b>	<b>Lënda</b>	<b>Vëllimi i orëve për çdo lëndë</b>	<b>Peshat në %</b>
<b>1</b>	Gjeodezi	133	50
<b>2</b>	Llogaritje gjeodezike	42	16
<b>3</b>	Gjeodezi e zbatuar	66	25
<b>4</b>	Gjeoinformatikë	26	9
	<b>TOTALI</b>	<b>267</b>	<b>100%</b>

#### **Temat sipas lëndëve janë:**

- a) “**Gjeodezi**”, kl 10, 11, 12, 13-të; **(133 orë)**
- Mjetet e thjeshta dhe matjet gjeodezike me to 10 orë
  - Instrumentet matës 12 orë
  - Matja e këndeve horizontale 10 orë
  - Matja e këndeve vertikale 5 orë
  - Matja e largësive me metër shirit 6 orë
  - Matja e largësive me mënyrën parallaktike 6 orë

• Matja e largësive me mënyrën optike	6 orë
• Matja e largësive me mënyrën elektro-optike	4 orë
• Instrumentet e matjes së lartësive	12 orë
• Hartat dhe planet, përmbajtja e tyre	12 orë
• Rilevimi takeometrik, punimet fushore	8 orë
• Rilevimi takeometrik, punimet kamerale	8 orë
• Bazamenti gjeodezik	8 orë
• Nivelimi shtetëror	8 orë
• Kadastrat e tokave nën kulturë	10 orë
• Përpilimi i librit të skicave si dhe plotësimi i regjistrit të tokave nën kulturë	8 orë
<b>b) “Llogaritje gjeodezike”, kl. 11-të</b>	<b>(42 orë)</b>
• Formulatat bazë të llogaritjeve gjeodezike	18 orë
• Llogaritja e poligonit të mbyllur	10 orë
• Llogaritja e poligonit të hapur	14 orë
<b>c) “Gjeodezi e zbatuar”, kl. 12, 13-të</b>	<b>(66 orë)</b>
• Mënyrat e piketimit të objekteve	10 orë
• Punimet gjeodezike në projektimin dhe ndërtimin e rrugëve	10 orë
• Punimet gjeodezike në projektimin dhe ndërtimin e urave	10 orë
• Punimet gjeodezike për nivelimin e zonave të ndërtimit	10 orë
• Punimet gjeodezike në veprat hidroteknike	10 orë
• Piketimi i linjave të tensionit të lartë	6 orë
• Punimet gjeodezike në projektimin dhe ndërtimin e tuneleve	10 orë
<b>d) “Gjeoinformatikë”, kl.12-të</b>	<b>(26 orë)</b>
• Llojet e bazës së të dhënave, rasterike dhe vektoriale.	10 orë
• Gjeoreferencimi si proces. Softuerët për gjeoreferencim.	8 orë
• Roli i gjeoreferencimit në gjeodezi dhe mënyrat e gjeoreferencimit.	8 orë